



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 121, Datë 24.05.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA
HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2 prot., datë 18.05.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636 prot., datë 09.05.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar.
- Në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal si dhe

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërma “d”;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregimit të energjise elektrike - neni 9, pika 4.8, gërma “c”.

Rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit si vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE, Vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës së Tiranës për administratorin, vetë shoqërinë dhe përfaqësuesin e saj ligjor, në zbatim të nenit 7, pika 2 gërma “b” të rregullores.**
- **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). **Shoqëria nuk ka përcjellë strukturën e organizimit të saj.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (Vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet respektive me data të rifreskuara në zbatim të nenit 8 pika 3 të rregullores.**
- **gërma “b”** (Bilanci financiar i tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). **Shoqëria nuk ka depozituar në ERE pasqyrat financiare për vitin 2021.**
- **gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj). **Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.**

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8:

- **gërma “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve); Shoqëria nuk ka depozituar informacion mbi sasi të e parashikuara për tu tregtuar për pesë vitet e licencës.
- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). **Shoqëria nuk ka depozituar një dokument ku të specifikohet kapitali**

financiar që vë në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Duke qenë se nuk është plotësuar një pjesë e konsiderueshme e dokumentacioni juridiko-administrativ dhe fiskal dhe dokumentacioni teknik për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet subjekti është i paplotësuar, vlerësohet të mos fillojë procedura për licencimin e shoqërisë “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike.
- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e këtij vendimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.